



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 11 të Ligjit për Zonat Ekonomike , Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.05.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

#### VENDIM

#### PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PUBLIK PËR VENDOSJE TË BIZNESEVE NË ZONËN EKONOMIKE "PARKU INDUSTRIAL" NË ZK QYLAGË –FAZA E PARË

I . Me këtë Vendim fillon procedura për shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë- faza e parë.

II.OBLIGOHET, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim që menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të shpallë Konkursin publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë- faza e parë.

III. Forma e konkursit publik, të përgaditet konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

IV. Qëllimi dhe destinimi i zonës së themeluar ekonomike është që kjo zonë ekonomike të shërbejë për inkurajimin e investitorëve që të konkurojnë në bazë të konkursit për investime sipas nenit 12 pika 1,2 dhe 3 te ligjit për Zonat Ekonomike Nr.04/L-

V. Parcelat kadastrale të cilat do të ipen në shfrytëzim në fazën e parë përfshijnë sipërfaqen prej 6.8 ha nga sipërfaqja e përgjithshme prej 56.27.56 ha në ngastrën kadastrale nr. P-71409090-00476-0 në ZK Qylagë.

VI. Prona e paluajtshme që do tu ipet në shfrytëzim subjekteve ekonomike do të jetë në afat prej 99 viteve.

VII. Bizneset të cilat do të përzgjidhen konform procedurave të përcaktuara me dispozita ligjore në tri (3) vitet e para nga dita e nënshkrimit të kontratës me komunën nuk do të paguajnë kompensim ndërsa pas tri viteve do të paguajnë si në tabelën më poshtë.

Vitet e Operimit	Çmimi m2	Çmimi për 1 Ha
Në 3 (tri) vitet e para	0.00 euro	00.00 euro
Prej vitit të 4 (katërt) deri në vitin e 7(shtatë)	0.07 euro	700.00 euro
Prej vitit të 8 (tetë) deri në vitin e 10(dhjetë)	0.11 euro	1,1000.00 euro
Prej vitit 11(njëmbëdhjetë)	0.125 euro	1.250.00 euro

VIII. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi obligohet të bëjë ndarjen –parcializimin e sipërfaqes e cila planifikohet të ipet në shfrytëzim.

IX. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

15 Nr. 33901-28080

Lipjan, më 31.05.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

